



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 2.12.2021

Lënda: Bisedime përfundimtare të Komisionerit Publik në çështjen ankim kundër vendimit nr. 332, datë 12.1.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Lindita Male (Ziguri)

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, parashtrimeve me shkrim, të paraqitura në seancat gjyqësore të datave 20.10.2021 dhe 18.11.2021, provave të administruara gjatë hetimit të zhvilluara në kuadër të këtij gjykimi, Komisioneri Publik, për secilin shkak ankim, konstaton se gjendemi në rastet e parashikuara nga pika 3 dhe 5, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

I. Vlerësimi për kriterin e pasurisë

1. *Lidhur me shkakun ankimor, mbi aktivitetin tregtar të personit të lidhur (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), në periudhën 2005-2007 dhe çështje të lidhura me të, Komisioneri Publik, referuar akteve të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, gjen të provuar se ky aktivitet tregtar nuk justifikon veprimet juridike dhe transaksionet financiare, që pretendohet se janë kryer për efekt të këtij aktiviteti tregtar.*

2. U provua, përfshirë aktet e përcjella nga *** Bank, për efekt të këtij gjykimi, gjatë këtij gjykimi, se personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit, edhe pse ka qenë palë në veprime juridike, të hartuara rregullisht sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar në fushën e noterisë, nuk ka qenë

investitor apo përfitues i të ardhurave të gjeneruara nga kontratat e porosisë ose të shitjes së pasurive në godinën e banimit, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, në cilësinë e subjektit tregtar.

3. Në referencë të akteve shkresore, me fuqi të plotë provuese, të administruara gjatë gjykimit, rezulton se në pasqyrat financiare të aktivitetit tregtar të personit të lidhur, sikurse kërkohet nga legjislacioni përkatës, veprimet, e pretenduara të kryera në cilësinë e administratorit të personit juridik, mungojnë, duke lënë të pabazuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mungesën e detyrimit ligjor për deklarimin e tyre.

3.1 Në vijim të këtij arsyetimi, lidhur me marrëdhënien kontraktuale ndërmjet z. ***.***, i cili pretendon se ka vepruar në cilësinë e ortakut të vetëm dhe administratorit të shoqërisë “****.***” sh.p.k., dhe shtetasit ***.***, Komisioneri Publik, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, konstaton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se shuma 40.000 euro, që përmendet në kontratën noteriale të porosisë¹, në fakt nuk është dorëzuar nga shtetasi ***.***, mbetet në nivel deklarativ, pasi nuk u administrua ndonjë akt për të provuar revokimin e kontratës noteriale të porosisë me shtetasin ***.*** dhe kthimin e shumës së paguar.

3.2 Ky pretendim i subjektit të rivlerësimit vjen në kundërshtim me parashikimin e nenit 3.2 të kontratës së porosisë, në të cilën specifikohet se shuma 40.000 euro paguhet me lidhjen e kësaj kontrate noteriale, akt shkresor, i cili përbën provë të plotë për përmbajtjen e tij, në mungesë të një akti me fuqi të njëjtë ligjore (akt noterial), që ta ketë ndryshuar apo shfuqizuar atë. Në mungesë të pasqyrit të këtyre veprimeve juridike dhe financiare, si pjesë e aktivitetit tregtar të subjektit juridik, me ortak të vetëm dhe administrator personin e lidhur, ka qenë detyrim deklarimi i kësaj shume në deklarimin përkatës vjetor.

3.3 Edhe nëse marrim në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se shuma 40.000 euro nuk është dorëzuar nga shtetasi ***.***, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në ditën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, Komisioneri Publik konstaton se, pak javë më vonë, kontrata e mësipërme e porosisë ka vijuar të prodhojë efekte juridike mes palëve.

3.4 Në të njëjtat rrethana juridike mungon pasqyrimi i veprimeve juridike dhe financiare, si pjesë e aktivitetit tregtar të subjektit juridik, me ortak të vetëm dhe administrator personin e lidhur, në rastin e kalimit të shumës prej 99.000 euro, pak javë më vonë nga lidhja e kontratës, nga llogaria personale e shtetasit ***.***, palë në kontratën e porosisë, në llogarinë personale të personit të lidhur dhe tërheqja e shumës prej tij. Këto veprime, në tërësinë e tyre, në dukje më së paku fiktive, nuk gjejnë pasqyrim në deklaratat periodike vjetore dhe në atë “Vetting”.

3.5 Komisioneri Publik konstaton se në të tilla rrethana juridike dhe fakti, ku bazuar në akte shkresore me fuqi të plotë provuese, të cilat nuk rezultojnë të jenë ndryshuar ose shfuqizuar më vonë në kohë, si dhe në dokumentacion bankar të plotë: *(i)* personi i lidhur ka përfituar shumën prej 40.000 euro me lidhjen e kontratës noteriale të porosisë; *(ii)* personi i lidhur ka kryer veprime në llogari bankare individuale për shumën prej 99.000 euro; *(iii)* këto veprime juridike dhe transaksione financiare nuk janë deklaruar nga personi i lidhur/subjekti i rivlerësimit në deklaratat vjetore dhe në atë “Vetting”, edhe pse në kushtet e mungesës së konfliktit të interesit në kryerjen

¹ Referohuni Kontratës së Porosisë nr. ***, datë **.11.2006, administruar në dosje të Komisionit.

e funksionit të saj, subjekti i rivlerësimit gjendet në rastet e parashikuara nga pika 3 dhe 5, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

4. *Lidhur me shkakun ankimor që lidhet me burimet e krijimit të pasurisë “Apartament banimi me sip. 68.8 m², në Tiranë”*

4.1 *Së pari*, lidhur me huan në shumën 5.000 euro, Komisioneri Publik, në analizë të pretendimeve dhe provave të administruara lidhur me këtë shkak ankimi, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, si dhe bazuar në Rekomandimin e ONM-së, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me mundësinë e huadhënësit për të mbuluar me burime të ligjshme huan në shumën 5.000 euro, dhënë subjektit të rivlerësimit.

4.2 *Së dyti*, sikundër është trajtuar më gjerësisht në ankimin e Komisionerit Publik, subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën për sa ka konstatuar Komisioni lidhur me pamjaftueshmërinë financiare për burimin e deklaruar: *kursime në shumën 3.000 euro*.

4.3 Sa më lart, subjekti i rivlerësimit nuk provoi mbulimin me burime të ligjshme të pagesës të këstit të parë të apartamentit me sip. 68.8 m,² të kryer në datën **.4.2008. Ky konstatim vlerësohet në harmoni me gjetjet e pasqyruara më lart në këto bisedime përfundimtare, duke mbetur për t’u konsideruar si element në verifikimin e rastit të parashikuar nga pika 3, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

5. *Lidhur me shkakun ankimor “Huamarrje në periudhën 1993-1994, të personit të lidhur, z. *** **”, Komisioneri Publik konstaton se, nga shqyrtimi gjyqësor në Kolegj, nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të jetë ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit gjatë ushtrimin të detyrës së saj si prokurore me palët huadhënëse të personit të lidhur me të.*

6. *Lidhur me shkakun ankimor mbi mungesën e një arsytimi për vlerësimin tërësor të kriterëve të rivlerësimit, Komisioneri Publik, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, konstaton se subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me mungesën e deklarimit nga personi i lidhur i detyrimeve, që rrjedhin nga zëvendësimi i debitorit me debitorin e ri, z. ***.***.*

6.1 Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit mbi mungesën e dijenisë lidhur me këtë detyrim nga ana e personit të lidhur dhe, rrjedhimisht, edhe nga subjekti i rivlerësimit, sikundër rezulton dhe nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet nr.***, datë **.3.2002, me objekt: *“Zëvendësim debitori”*, i padituri ***.***, i përfaqësuar rregullisht nëpërmjet përfaqësuesit të tij me prokurë, ka pranuar të marrë përsipër detyrimin e paditësit ***.***.

6.2 Subjekti i rivlerësimit, gjatë këtij gjykimi, nuk paraqiti ndonjë provë në funksion të goditjes gjyqësore, në lidhje me pavlefshmërinë e akteve të përdorura gjatë kryerjes së procedurave gjyqësore për zëvendësimin e debitorit ose dhe vetë vendimit gjyqësor, që ka disponuar përfundimisht, duke njohur personin e lidhur në cilësinë debitorit.

6.3 Mungesa e dijenisë së personit të lidhur për ekzistencën e këtij detyrimi, duket kontradiktore dhe me përmbajtjen e shkresës nr.*** prot., datë **.6.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ku konfirmohet se personi i lidhur, z. ***.***, figuron i regjistruar si anëtar i bordit të menaxhimit në subjektin “****” sh.a., me aksioner dhe administrator shtetasin ***.***.

6.4 Në përfundim të sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk e kanë deklaruar këtë detyrim në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën “Vetting”.

6.5 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se, lidhur me deklarin e këtij detyrimi, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarin të pasaktë dhe të paplotë.

7. Kërkimi përfundimtar

7.1 Duke përfunduar për sa parashtruar, bazuar edhe në Rekomandimin e ONM-së, Komisioneri Publik vlerëson se:

7.2 Në referencë të analizës së provave/akteve të administruara në dosje të Komisionit, provave dhe akteve të administruara gjatë hetimit gjyqësor, të vendosura nga trupi gjykues, si dhe parashtrimeve dhe akteve/provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e provës, gjatë këtij hetimi gjyqësor, në vlerësimin tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 61, pika 3 dhe 5, e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë;

7.3 Bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkohet nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 332, datë 12.1.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri).

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA